



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 227/25 Dt. 04.04.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 29 paragrafi 1.1, neni 30 paragrafi 2 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e nënave (lehona) që kanë lindur fëmijë gjatë vitit 2024

- Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesën e nënave (lehona), që kanë lindur fëmijë gjatë vitit 2024, si në vijim:
 - 1.1. Për fëmijën e parë (1) të lindur ndahet shuma financiare prej 250.00 €,
 - 1.2. Për fëmijën e dytë (2) të lindur ndahet shuma financiare prej 300.00 €,
 - 1.3. Për fëmijën e tretë (3) e më tepër të lindur ndahet shuma financiare prej 350.00 €.
- Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
- Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komisioni i formuar me vendim 01 nr. 135/25, datë 20.02.2025 dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Komisionit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.